



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

---

Numri i lëndës: 2022:188491  
Datë: 28.08.2024  
Numri i dokumentit: 06094527

**PPP.nr.293/22**

**GJYKATA THEMELORE MITROVICË**, si përmbartimore, e përberë nga gjyqtari Genc Hasani dhe me bashkëpunëtoren profesionale Valbona Berisha, duke vendosur në çështjen përmbartimore të kreditorit Sh. a “KUR” J.S.C. me adrese rr. “Bislim Bajgora” - Mitrovice, kundër debitorit S. H., me adrese “M. T. – M., lidhur me propozimin për kthim në gjendjen e mëparshme, jashtë seancës, me dt.28.08.2024, nxjerr këtë:

**A K T V E N D I M**

**LEJOHET** propozimi mbi kthimin në gjendjen e mëparshme i debitorit S. H., me adrese “M. T. – M, i parashtruar kundër urdhrin përmbartimor P.nr... dt. .... **PRISHEN** të gjitha veprimet e ndërmarra nga ana e përmbartuesit privat pas lejimit të përmbartimit dhe procesi gjyqësor në këtë çështje përmbartimore do të kthehet në stadin e dërgimit të njoftimit të kreditorit për përgjigje në prapësim.

**A r s y e t i m**

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit SH.A. KUR “Mitrovica” J.S.C., me seli në Mitrovicë, me datë ..., ka lëshuar Urdhrin përmbartimor P.nr. ..., të datës ..., me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm, përkatësisht kartelës financiare të konsumatorit, të datës ..., në emër të S.Z. nga M., për shfrytëzimin e ujësjellësit dhe shërbimeve të kanalizimit për periudhën kohore ... gjerë më datë ..., në shumën prej ...€, me të cilin ka kërkuar që të detyrohet debitori që kreditorit t’ia paguaj borxhin kryesor, së bashku me kamatën ligjore prej 8%, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij urdhri, në të kundërtën, të bllokohen llogaritë bankare të debitorit ose të bëhet regjistrimi dhe sekuestrimi i sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme.

Përmbartuesi privat me dt. ..., e ka lejuar dhe e ekspeduar propozimin për përmbartim në adresë të debitorit ku nga flet kthesa me dt. ..., konsiderohet se debitori e ka pranuar propozimin për përmbartim.

Debitori S.H., me dt....., ka bërë kërkesë për kthimin në gjendjen e mëparshme, me arsyetimin se propozimi për përmbartim nuk është dërguar tekë unë pasi që, në atë banës ku unë kame banuar,

banon një person tjetër i cili nuk ka qene ne dijeni për adresën time te banimit, por qe rastësisht e kam takuar ne qytet me dt...., dhe me ka njoftuar ne lidhje me urdhrin përmbarrimor andaj kjo është arsyeja qe me ka ikur afati ligjor për prapësim.

Gjykata, pas shikimit të shkresave të lëndës, duke u bazuar në nenin 110 par.1 të LPK-së, i cili flet për dorëzimin e shkresave personave i cili thotë citoi *“Padia, përgjigjja në padi, letërthirrrja për në seancë, urdhërpagesa, aktgjykimi dhe aktvendimi, kundër të cilit lejohet ankim i veçantë, mjete i goditjes së vendimit, i dorëzohet personalisht palës, gjegjësisht përfaqësuesit ligjor apo përfaqësuesit me prokurë të saj. Shkresat e tjera do t’i dorëzohen personalisht adresatit kur një gjë e këtillë shprehimisht parashihet me këtë ligj apo kur gjykata konkludon se për shkak të dokumenteve origjinale që i janë bashkangjitur shkresës që duhet dorëzuar, ose nga ndonjë shkak tjetër, nevojitet kujdes i shtuar ”*, ndërsa apar.2 i te njëjtit nen thotë se *“Në qoftë se personi të cilit duhet dorëzuar personalisht shkresa nuk gjendet atje ku duhet bërë dorëzimi, dorëzuesi do të njoftohet se kur dhe ku do të mund ta gjejë këtë person dhe do t’ia lejë ndonjë personi të theksuar në nenin 111 paragrafi 1 dhe 2 të këtij ligji njoftimin me shkrim që për marrjen e shkresës të jetë në ditën dhe në orën e caktuar në banesën e vet, përkatësisht në vendin e vet të punës”,* kurse par.3 thotë *“Po që se edhe pas kësaj dorëzuesi i shkresës nuk e gjen personin të cilit duhet dorëzuar shkresa, atëherë ai do të veprojë sipas dispozitave të nenit 111 të këtij ligji, dhe kështu dorëzimi do të konsiderohet i kryer”,* ndërsa neni 111 par.1 thotë *“Po që se personi të cilit duhet bërë dorëzimi i shkresës nuk gjendet në banesën e vet, dorëzimi bëhet duke iu dhënë shkresa ndonjë anëtar të rritur të familjes së tij, i cili ka për detyrë ta marrë shkresën në dorëzim, e po që se as këta nuk gjenden në banesë, shkresa do t’i jepet fqinjit, po që se pajtohet me një gjë të këtillë. Dorëzimi i kryer në këtë mënyrë konsiderohet i vlefshëm”,* e nga flet kthesa e dt. 04.08.2022 konstatohet se propozimin për përmbarrim nuk e ka pranuar debitori e duke u bazuar ne dispozitat e lartcekura vërtetohet se personi qe e ka pranuar propozimin nuk është debitori, e ne rastin konkret kemi te bëjmë me dorëzimin e shkresave personalisht palës, e rrjedhimisht gjykata duke u bazuar në dispozitat e lartcekura e lejoi propozimin për kthimin në gjendjen e mëparshme, pasi që te njëjtit ju ka mohuar e drejta ne ushtrimin e mjeteve efektive-juridike ne lidhje me nenin 33 te Kushtetutës se Republikës se Kosovës i cili nen parasheh se *“Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj”,* e ne lidhje me nenin 6 te Konventës Evropiane për Mbrojtjen e te Drejtave te Njeriut.

Gjykata duke u bazuar në nenin 68 par 2. i cili thotë citoi *“Kthimi në gjendjen e mëparshme është i lejuar vetëm në rastet e mos ruajtjes së afateve për paraqitjen e prapësimin dhe ankesës kundër vendimeve të përmbarrueshëm për përmbarrimin me dhunë”*.

Gjykata pasi që ka analizuar situatën konkrete ka vërejtur se debitori e ka zanë afatin për kthim në gjendje të mëparshme sepse duke u bazuar në nenin Neni 130. Par.2 I cili thotë citoi *“Propozimi duhet të paraqitet brenda afatit shtatë (7) ditor nga dita kur ka pushuar shkaku i mosveprimit, e po që se pala më vonë ka mësuar për mosveprimin, atëherë afati llogaritet nga dita kur ka mësuar për mosveprimin”,* ndërsa neni 130.3 thotë citoi *“Pas kalimit të gjashtëdhjetë (60) ditëve nga dita e mosveprimit nuk mund të kërkohet kthimi në gjendjen e mëparshme”*.

Gjykata Themelore në Mitrovicë, si përmbartimore në zbatim të dispozitave të nenit 68 të LPP, dhe 129 par 1 e 2 të LPK-së vlerësoi propozimin e debitorit dhe gjeti se i njëjti është i bazuar. Dhe se prapësimi i debitorit duhet dërguar kreditorit për përgjigje e pas kësaj procedure t'i sjellët gjykatës për vendim meritot.

Prandaj nga arsyet e cekura më lartë, e konform dispozitave të nenit 3, 17, 68, të Ligjit të Procedurës Përmbartimore, në lidhje me nenin 110 par.1,2 dhe 3,111 par.1, 129 par 1 e 2, 130 par 2 dhe 3 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**  
**Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil**  
**PPP.nr.293/22 dt.28.08.2024**

**GJYQTARI**

---

Genc Hasani

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij Aktvendimi nuk është e lejuar e drejta në Ankesë, duke u bazuar në dispozitën e nenit 133 par.3, të LPK-së.